



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.legjislacioni.gov.al

Nr. 74

Datë 27 maj 2014

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 45/2014 datë 24.4.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar.....	2679
Vendim i Kuvendit nr. 34/2014 datë 22.5.2014	Për rrëzimin e dekretit nr. 8566, datë 16.5.2014, të Presidentit të Republikës, për “Kthimin e ligjit nr. 45/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar”....	2681
Dekret nr. 8566 datë 16.5.2014	Për kthimin e ligjit nr. 45/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar”.....	2681
Vendim i Kuvendit nr. 29/2014 datë 22.5.2014	Për publikimin e shpalljes së vendit vakant të Kryetarit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.....	2681
Vendim i Kuvendit nr. 30/2014 datë 22.5.2014	Për vendimmarrjen e Kuvendit, lidhur me institucionin e Komisionit të Shërbimit Civil dhe zgjedhjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.....	2682
Vendim i Kuvendit nr. 31/2014 datë 22.5.2014	Për ndërprerjen e mandatit të zotit Alfred Prifti si anëtar i Komisionit të Shërbimit Civil.....	2682
Vendim i Kuvendit nr. 32/2014 datë 22.5.2014	Për ndërprerjen e mandatit të zotit Fatmir Tafaj si anëtar i Komisionit të Shërbimit Civil.....	2682

Vendim i Kuvendit nr. 33/2014 datë 22.5.2014	Për procedurën paraprake të përzgjedhjes së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.....	2682
Vendim i Kuvendit nr. 35/2014 datë 22.5.2014	Për mosdhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Alaudin Malaj anëtar i Gjykatës së Lartë.....	2683
Vendim i Kuvendit nr. 36/2014 datë 22.5.2014	Për mosmiratimin e kërkesës së një grupi deputetësh “Për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për verifikimin e fakteve dhe rrethanave të bëra publike për fenomenin e rritjes së trafikut të drogës, përfshirë përdorimin e hapësirës ajrore nga narkotrafikantët”	2683
Rezolutë e Kuvendit datë 22.5.2014	Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë (ERE) për vitin 2013.....	2683

LIGJ
Nr. 45/2014

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN
NR. 9049, DATË 10.4.2003, “PËR DEKLARIMIN
DHE KONTROLLIN E PASURIVE, TË
DETYRIMEVE FINANCIARE TË TË
ZGJEDHURVE DHE TË DISA NËPUNËSVE
PUBLIKË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) zyrtarët e nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues, sipas legjislationit në fuqi për nëpunësin civil;

2. Shkronja “f” ndryshohet si më poshtë:

“f) zyrtari i administratës doganore dhe tatimore, që merret me mbledhjen e të ardhurave doganore ose tatimore, me përjashtim të zyrtarëve të administratës tatimore të qeverisjes vendore;”.

Neni 2

Në nenin 4 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) sende me vlerë të veçantë mbi 300 000 (treqind mijë) lekë;”.

2. Shkronja “d” ndryshohet si më poshtë:

“d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash* jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lek ose në valutë të huaj;”.

3. Shkronja “h” ndryshohet si më poshtë:

“h) çdo shpenzim i deklarueshëm, me vlerë mbi 300 000 (treqind mijë) lekë, i kryer gjatë vitit të deklarimit.”.

Neni 3

Pas nenit 4 shtohet neni 4/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 4/1

Të gjithë zyrtarët, të cilët për shkak të funksionit publik që kryejnë, bëhen subjekte të këtij ligji dhe plotësojnë deklarimin për herë të parë, sipas nenit 5/1, të tij, nuk mund të mbajnë dhe të deklarojnë gjendje në *cash* jashtë

sistemit bankar mbi shumën 1,5 (një presje pesë) milion lekë.

Për zyrtarët që deklarojnë, sipas nenit 5/1, të këtij ligji, depozitimi në institucionet bankare i gjendjeve *cash* mbi vlerën e parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, është i detyrueshëm përpara dorëzimit të deklaratës së interesave privatë në ILDKPKI.”.

Neni 4

Neni 11 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 11

1. Organi përgjegjës për kontrollin e deklarimit të pasurive është Inspektori i Përgjithshëm.

2. Inspektori i Përgjithshëm zgjidhet me shumicën e gjithë anëtarëve të Kuvendit për një mandat 5-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

3. Kuvendi i Shqipërisë, jo më vonë se tre muaj përpara përfundimit të mandatit të përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, publikon shpalljen për vendin vakant të Inspektorit të Përgjithshëm.

4. Në rastet e mbarimit të mandatit, sipas nenit 14 të këtij ligji, shpallja për vendin vakant të Inspektorit të Përgjithshëm bëhet kryesisht nga Kuvendi, brenda 10 ditëve nga krijimi i vakancës.

5. Çdo shtetas, i cili plotëson kushtet e nenit 12 të këtij ligji, mund të paraqesë në Kuvend kandidaturën për Inspektor të Përgjithshëm. Kërkesa shoqërohet me dokumentacionin përkatës, që provon përmbushjen e kushteve ligjore dhe kritereve objektive.

6. Lista e kandidatëve i kalon komisionit të Kuvendit që mbulon çështjet ligjore për të verifikuar përmbushjen e kritereve dhe kushteve përkatëse.

Komisioni i shqyrton kandidaturat në përputhje me Rregulloren e Kuvendit. Pas verifikimit të kushteve dhe kritereve zbatohet procedura si më poshtë:

a) komisioni përzgjedh, për t’iu paraqitur për votim Kuvendit, tre kandidatët që gëzojnë mbështetjen më të madhe të anëtarëve të komisionit, por jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij. Çdo anëtar i komisionit mund të mbështesë deri në katër kandidatë;

b) nëse shumicën e cilësuar, sipas shkronjës “a”, nuk e gëzojnë së paku tre kandidatë, komisioni identifikon tre kandidatët që kanë marrë mbështetjen më të madhe midis anëtarëve të komisionit, pas zbatimit të shkronjës “a”;

c) kur gjatë zbatimit të shkronjave “a” dhe “b” dy apo më shumë kandidatë gëzojnë të njëjtën mbështetje, përzgjedhja e tyre bëhet me short.

Kandidatët e përzgjedhur, sipas procedurës së mësipërme, i kalojnë Kuvendit për votim.

7. Inspektori i Përgjithshëm bën deklarimin e parë të pasurisë brenda 30 ditëve nga zgjedhja e tij dhe çdo vit, sipas nenit 4 të këtij ligji, pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

8. Pas përfundimit të mandatit, me pëlqimin e tij, ai ka të drejtë të emërohet në funksionin ose detyrën publike që kishte para zgjedhjes së tij ose në një vend të barasvlershëm me vendin e mëparshëm. Ai nuk përfiton nga kjo e drejtë, në rastet kur shkarkohet për shkelje të rëndë të ligjit ose për akte dhe sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e Inspektorit të Përgjithshëm.”.

Neni 5

Neni 12 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 12

Kushtet dhe kriteret për t’ u zgjedhur

1. Inspektor i Përgjithshëm mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që në momentin e kandidimit përmbush këto kushte ligjore:

- a) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik ose ekonomik në profilin financë, Diplomë e Nivelit të Dytë;
- b) të ketë vjetërsi në profesion, si jurist ose ekonomist financiar, jo më pak se 15 vjet;
- c) të mos jetë i dënuar penalisht me vendim të formës së prerë;
- ç) të mos jetë anëtar i partive politike, deputet, ministër, zëvendësministër, pjesëtar në strukturat e Policisë së Shtetit, Forcat e Armatosura dhe Shërbimin Informativ Shtetëror.

2. Kandidati që përmbush kushtet ligjore, të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, zgjidhet Inspektor i Përgjithshëm në bazë të këtyre kriterëve objektive:

- a) vjetërsisë në profesion;
- b) përvojës së veçantë profesionale në fushën e së drejtës penale/administrative ose veprimtarinë audituese;
- c) ecurisë gjatë kryerjes së arsimit të lartë;
- ç) të gëzojë integritet të lartë moral, ku përfshihen, ndër të tjera, transparenca e plotë dhe e dokumentuar e të gjitha të ardhurave dhe asetëve, pagimi i të gjitha detyrimeve tatimore, si dhe informacionet zyrtare, të marra nga institucione të tjera publike, përfshirë dhe informacionet konfidenciale.”.

Neni 6

Në nenin 14 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Inspektori i Përgjithshëm mund të shkarkohet nga Kuvendi vetëm me kërkesë të motivuar të jo më pak se një së tretës së deputetëve:

- a) për shkelje të dispozitave të këtij ligji;
- b) kur kryen veprimtari që krijon konflikt interesash;
- c) kur zbulohen raste të papajtueshmërisë së funksionit të tij.”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Në këtë rast Kuvendi vendos me shumicën e gjithë anëtarëve të tij.”.

Neni 7

Neni 21 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 21

Deklarimi i pasurive, i burimeve të tyre, i detyrimeve financiare bëhet sipas kërkesave të përcaktuara në këtë ligj dhe në formën e përcaktuar nga Inspektori i Përgjithshëm. Deklarimi përfshin pasurinë e subjektit dhe të familjes së tij (bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve në moshë madhore), burimet e krijimit dhe detyrimet financiare të subjektit. Deklarimi duhet të përmbajë edhe faktin nëse deklaruesi/ja ka ose jo persona të tjerë të lidhur.”.

Neni 8

Neni 24 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 24

Inspektorati i Lartë bën përpunimin paraprak të deklarimeve, i cili përfshin juridiksionin, rregullsinë e plotësimin të deklaratës dhe të anekseve të saj.

Kur nga përpunimi paraprak vërtetohen gabime materiale ose plotësime të gabuara, inspektorati njofton subjektin që ka paraqitur këto deklarime, i cili, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit, është i detyruar t’i ndreqë ato.

Deklaratat e interesave privatë, pas dorëzimit dhe regjistrimit, kalojnë menjëherë në skanimin fizik dhe ruhen në sistemin e programuar elektronik të ILDKPKI-së.

Vetëm pas përfundimit të procedurave të skanimit, deklaratat e interesave privatë kalojnë në përpunimin paraprak, kontrollin aritmetik e logjik dhe me pas në kontroll të plotë.

Procedurat e pranimit, skanimit dhe përpunimit paraprak miratohen nga Inspektori i Përgjithshëm.”.

Neni 9

Në nenin 25, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Kontrolli aritmetik dhe logjik kryhet për çdo deklaram, për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurive nga burime të deklaruara.

Ky proces kontrolli kryhet brenda vitit kalendarik të dorëzimit të deklaratave të interesave privatë të zyrtarëve dhe personave të lidhur me ta në ILDKPKI.”.

Neni 10

Në nenin 25/1 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 1, pas shkronjës “c” shtohen shkronjat “ç” dhe “d” me këtë përmbajtje:

“ç) çdo 4 vjet për të gjithë gjyqtarët e gjykatës së shkallës së parë dhe prokurorët e rrethit gjyqësor të shkallës së parë;

d) çdo 7 vjet për zyrtarët e tjerë të papërfshirë në shkronjat e mësipërme.”.

2. Pikat 2 dhe 3 shfuqizohen.

Neni 11

Në nenin 34, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Inspektori i Përgjithshëm, në përputhje me pikën 1, të këtij neni, përcakton procedurat se si veprohet për publikimin e të dhënave të interesave privatë që deklarohen pranë Inspektoratit të Lartë për zyrtarët dhe personat e lidhur me ta.”.

Neni 12

Pas nenit 42 shtohet neni 42/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 42/1

Dispozitë kalimtare

Inspektori i Përgjithshëm vazhdon të qëndrojë në detyrë edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, deri në përfundim të mandatit të parashikuar në kohën e emërimit të tij.”.

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Ilir Meta**

Miraturar në datën 24.4.2014

**VENDIM
Nr. 34/2014**

PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR. 8566, DATË 16.5.2014, TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS, PËR “KTHIMIN E LIGJIT NR. 45/2014, “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9049, DATË 10.4.2003, “PËR DEKLARIMIN DHE KONTROLLIN E PASURIVE, TË DETYRIMEVE FINANCIARE TË TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA NËPUNËSVE PUBLIKË”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 85, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Rrëzimin e dekretit nr. 8566, datë 16.5.2014, të Presidentit të Republikës, për “Kthimin e ligjit nr. 45/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Ilir Meta**

Miraturar në datën 22.5.2014

**DEKRET
Nr. 8566, datë 16.5.2014**

PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 45/2014 “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9049, DATË 10.4.2003, “PËR DEKLARIMIN DHE KONTROLLIN E PASURIVE, TË DETYRIMEVE FINANCIARE TË TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA NËPUNËSVE PUBLIKË”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të neneve 93 dhe 85, pika 1, të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 45/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar”.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani**

**VENDIM
Nr. 29/2014**

PËR PUBLIKIMIN E SHPALLJES SË VENDIT VAKANT TË KRYETARIT TË AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 10, pika 2, të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Publikimin e shpalljes së vendit vakant të Kryetarit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit për zbatimin e këtij vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Ilir Meta**

Miraturar në datën 22.5.2014

**VENDIM
Nr. 30/2014**

**PËR VENDIMMARRJEN E KUVENDIT, LIDHUR
ME INSTITUCIONIN E KOMISIONIT TË
SHËRBIMIT CIVIL DHE ZGJEDHJEN E
KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E
SHËRBIMIT CIVIL**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", neni 12 i tij, si dhe në zbatim të neneve 19, pika 1, dhe 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Mbarimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Shërbimit Civil (krijuar sipas ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil").

II. Qëndrimin në detyrë të Sekretariatit Teknik të Komisionit të Shërbimit Civil deri në miratimin e strukturës së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

III. Fillimin e procedurave për zgjedhjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, përmes një procesi të hapur publik, konsensual, transparent dhe gjithëpërfshirës.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Ilir Meta**

Miraturar në datën 22.5.2014

**VENDIM
Nr. 31/2014**

**PËR NDËRPRERJEN E MANDATIT TË ZOTIT
ALFRED PRIFTI SI ANËTAR I KOMISIONIT TË
SHËRBIMIT CIVIL**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", neni 12 i tij, si dhe në zbatim të neneve 19, pika 1, dhe 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Ndërpritet mandati i zotit Alfred Prifti, si anëtar i Komisionit të Shërbimit Civil, i zgjedhur me vendimin e

Kuvendit nr. 105, datë 16.6.2011, në zbatim të nenit 5 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil".

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Ilir Meta**

Miraturar në datën 22.5.2014

**VENDIM
Nr. 32/2014**

**PËR NDËRPRERJEN E MANDATIT TË ZOTIT
FATMIR TAJ SI ANËTAR I KOMISIONIT TË
SHËRBIMIT CIVIL**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", neni 12 i tij, si dhe në zbatim të neneve 19, pika 1, dhe 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Ndërpritet mandati i zotit Fatmir Taj, si anëtar i Komisionit të Shërbimit Civil, i zgjedhur me vendimin e Kuvendit nr. 71, datë 4.11.2010, në zbatim të nenit 5 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil".

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Ilir Meta**

Miraturar në datën 22.5.2014

**VENDIM
Nr. 33/2014**

**PËR PROCEDURËN PARAPRAKE TË
PËRZGJEDHJES SË KOMISIONERIT PËR
MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", neni 12 i tij, si dhe në zbatim të nenit 19, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Miratohet procedura paraprake e përzgjedhjes së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, sipas fazave të mëposhtme:

a) Nga shërbimet e Kuvendit të bëhet shpallja dhe bërja publike e vakancës së organit të krijuar me ligj nga Kuvendi (në faqen zyrtare të Kuvendit dhe mjetet e

informimit publik), për një afat prej 15 ditësh nga publikimi. Në shpallje të përcaktohet edhe dokumentacioni që duhet të shoqërojë CV-në e kandidatit për përmbushjen e kriterëve ligjore, si dhe pëlqimi i kandidatit me shkrim.

b) Në përfundim të afatit të përcaktuar në shpallje, lista me kandidaturat e vetofruara u bëhet e njohur anëtarëve të Kuvendit.

c) Shërbimet e Kuvendit, brenda 5 ditëve nga dërgimi i njoftimit të deputetët i listës së kandidaturave të vetofruara, organizojnë dëgjuesën publike në mjediset e Kuvendit. Shërbimet e Kuvendit njoftojnë të gjithë deputetët/grupet parlamentare, për ditën, orën dhe mjediset ku do të kryhet dëgjesa publike dhe prezantimet e çdo kandidati në këtë proces të hapur.

ç) Pas dëgjësës publike, të paktën 28 deputetë përzgjedhin kandidatin/kandidatët, të cilët do të mbështesin për t'ia paraqitur Kuvendit, sipas cilësive profesionale dhe performancës gjatë prezantimit.

d) Kandidaturat që do të marrin mbështetjen e jo më pak se 28 deputetëve, depozitohen zyrtarisht në protokollin e Kuvendit dhe vazhdojnë procedurat e parashikuara në nenin 111 të Rregullores së Kuvendit.

II. Procedura paraprake, e propozuar në pikën I të këtij vendimi, nuk është e detyrueshme për t'u ndjekur nga deputetët, si dhe nuk përjashton në asnjë rast, që të paktën 28 deputetë t'i paraqesin Kuvendit një kandidat që është përzgjedhur prej tyre jashtë procedurës së sipërcituar.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Illir Meta

Miraturuar në datën 22.5.2014

VENDIM
Nr. 35/2014

PËR MOSDHËNIEN E PËLQIMIT PËR EMËRIMIN
E ZOTIT ALAUDIN MALAJ ANËTAR I GJYKATËS
SË LARTË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 136, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në dekretin e Presidentit të Republikës nr. 8515, datë 10.03.2014,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosdhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Alaudin Malaj anëtar i Gjykatës së Lartë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Illir Meta

Miraturuar në datën 22.5.2014

VENDIM
Nr. 36/2014

PËR MOSMIRATIMIN E KËRKESËS SË NJË
GRUPI DEPUTETËSH “PËR NGRITJEN E
KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR
VERIFIKIMIN E FAKTEVE DHE RRETHANAVE
TË BËRA PUBLIKE PËR FENOMENIN E RRIJTJES
SË TRAFIKUT TË DROGËS, PËRFSHIRË
PËRDORIMIN E HAPËSIRËS AJRORE NGA
NARKOTRAFIKANTËT”

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosmiratimin e kërkesës së një grupi deputetësh “Për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për verifikimin e fakteve dhe rrethanave të bëra publike për fenomenin e rritjes së trafikut të drogës, përfshirë përdorimin e hapësirës ajrore nga narkotrafikantët”, për shkak se objekti i punës së këtij komisioni është në kundërshtim me nenin 77 të Kushtetutës, si dhe me interpretimet që Gjykata Kushtetuese ka bërë në vendimet e saj me nr. 18, datë 14.5.2003, nr. 26, datë 4.12.2006, nr. 20, datë 4.5.2007, nr. 12, datë 20.5.2008, nr. 22, datë 5.5.2010 dhe nr. 30, datë 16.5.2014.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Illir Meta

Miraturuar në datën 22.5.2014

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ENTIT
RREGULLATOR TË ENERGJISË (ERE)
PËR VITIN 2013

Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke njohur Entin Rregullator të Energjisë, si rregullatori i vetëm dhe i pavarur për mbikëqyrjen e funksionimit të tregut të energjisë elektrike e të gazit natyror, si dhe për ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit dhe sipërmarrësve në këtë sektor;

- Duke njohur situatën e vështirë të krijuar në furnizuesin publik me pakicë “CEZ Shpërndarje”, sh.a., dhe ndikimin e performancës së këtij operatori në të gjithë tregun e energjisë elektrike;

- Duke qenë të vetëdijshëm se zhvillimet në sektorin e energjisë elektrike janë shoqëruar me hapa dhe procese të

rëndësishme nga pikëpamja e organizimit, menaxhimit dhe administrimit të tij;

- Duke pasur parasysh rolin gjithnjë e më të rëndësishëm që po merr operatori i tregut të energjisë elektrike, funksionet e të cilit po zgjerohen gradualisht me hapat që po hidhen për krijimin e një tregu të lirë të energjisë elektrike në rajon;

- Duke konsideruar që një liberalizim i mëtejshëm i tregut të energjisë elektrike garanton një siguri më të lartë furnizimi dhe një zhvillim më të mirë të tregut të energjisë elektrike;

- Duke e konsideruar si shumë të rëndësishëm forcimin e pavarësisë dhe të kapaciteteve profesionale të këtij rregullatori në përmbushjen e misionit;

- Duke njohur shkallën e lartë të riskut hidrologjik për sistemin tonë energjetik, i cili bazohet vetëm në HEC-e;

Konstaton se ERE në vitin 2013:

- Ka marrë vendim për heqjen e licencave të shoqërisë “CEZ Shpërndarje”, sh.a. për veprimtarinë e shpërndarjes e të furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike, si dhe për vendosjen e kësaj shoqërie në administrim të përkohshëm.

- Ka vijuar me licencimin e subjekteve në veprimtaritë e ndryshme të sektorit të energjisë elektrike, duke respektuar me rigorozitet transparencën në procedurat për licencim, sikundër edhe zbatimin e afateve të shqyrtimit të aplikimeve dhe miratimit të pajisjes me licencë të subjekteve aplikuese.

- Ka realizuar procedurat që lidhen me zhvillimin mëtejshëm të projektit të gazsjellësit TAP, duke u bazuar në një bashkëpunim dhe harmonizim të procedurave me autoritetet rregullatore në sektorin e energjisë në Itali dhe Greqi.

- Ka intensifikuar angazhimin e tij në përgatitjen dhe përditësimin e kuadrit rregullator të tregut të gazit natyror në vendin tonë, duke miratuar Metodologjinë e Tarifave, në përputhje me detyrimet e përcaktuara në “Opinionin e përbashkët përfundimtar”, si dhe për përfundimin e kushtëzuar të kompanisë TAP - AG prej kërkesave të disa dispozitave të Direktivës 2009/73/EC dhe të “Opinionit të përbashkët të rregullatorëve për aplikimin e TAP - AG për përfundimtar” për projektin TAP.

- Ka kryer periodikisht procese monitorimi ndaj operatorëve të licencuar në sektorin e energjisë elektrike, kryesisht në KESH, sh.a., lidhur me veprimtarinë e import - eksportit dhe shkëmbimet e energjisë elektrike, realizimin e investimeve, si dhe verifikimin e fluksit të parasë së kompanisë.

- Ka ushtruar kontroll të vazhdueshëm mbi shërbimet e kompanisë “CEZ Shpërndarje”, sh.a., duke u fokusuar në kontrollin e zgjidhjes së problemeve që lidhen kryesisht me humbjet në rrjet dhe mosrealizimin e arkëtimeve.

- Ka vijuar punën në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve të energjisë elektrike, duke ndikuar në

trajtimin me korrektësi dhe zgjidhjen në kohë të ankesave të konsumatorëve.

- Ka miratuar akte të rëndësishme nënligjore për plotësimin e kuadrit rregullator të nevojshëm për funksionimin e tregut të energjisë.

- Ka qenë bashkëpunuese me operatorët e tregut në sektorin e energjisë elektrike, duke organizuar takime periodike me ta.

- Ka qenë e angazhuar në forcimin e kapaciteteve administrative të vetat, përmes kualifikimeve të ndryshme, të mbështetura nga rregullatorët dhe nga organizmat ndërkombëtarë, me të cilët bashkëpunon.

Kërkon që ERE për vitin 2014:

- Të angazhohet në liberalizimin e mëtejshëm të tregut të energjisë elektrike, veçanërisht në liberalizimin e tregut të tensionit të mesëm, si një nga elementet që duhen ndërmarrë për përmirësimin e sektorit elektroenergjetik në Shqipëri, si dhe të angazhohet në krijimin e kushteve reale, që konsumatorët dhe përdoruesit të kenë interes për të kaluar në këtë treg të liberalizuar.

- Të intensifikojë përpjekjet dhe punën për monitorimin, në mënyrë të veçantë të kompanisë “CEZ Shpërndarje”, sh.a., për përmirësimin e treguesve kryesorë të saj në drejtim të humbjeve në rrjet dhe rritjes së arkëtimeve, duke qenë se shëndeti i kësaj kompanie është një nga elementet bazë që gjeneron një shëndet më të mirë edhe të sistemit energjetik.

- Të bashkëpunojë ngushtësisht dhe të sigurojë mbështetje për institucionet përgjegjëse në mbrojtjen e interesave të shtetit shqiptar në procedimet administrative apo gjyqësore, që kanë lidhje me konfliktin dhe mosmarrëveshjet me kompaninë “CEZ Shpërndarje”, sh.a.

- Të vazhdojë të jetë transparent dhe jodiskriminues në veprimtarinë e monitorimit të tregut të energjisë elektrike, si dhe të rrisë përpjekjet për të bërë të mundur sigurimin e kushteve për një treg konkurrues të energjisë elektrike.

- Të rrisë përpjekjet për eliminimin sa më të shpejtë të skemës së faturimit aforfe, duke i kërkuar “CEZ Shpërndarje”, sh.a. kryerjen e investimeve imediate në drejtim të pajisjes me matës të konsumatorëve, në bazë të një kalendari që duhet t’i paraqitet nga kompania.

- Të vazhdojë të garantojë mbrojtjen e konsumatorëve të energjisë elektrike, nëpërmjet trajtimit të ankesave të konsumatorëve, dhe të vijojë të angazhohet në përmirësimin e vazhdueshëm të kontratës së furnizimit të konsumatorëve.

- Të nxisë realizimin e projekteve publike apo private për lidhjen e rrjetit energjetik shqiptar me rrjetin rajonal.

- Të përmbushë detyrimin për rishikimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, Rregullat e Alokimit të Kapaciteteve, Kodet e Shpërndarjes e të Transmetimit dhe metodologjitë e përcaktimit të tarifave dhe çmimeve të energjisë, me qëllim harmonizimin me kushtet e reja të hapjes së tregut dhe përshtatjes së tij me tregun rajonal,

nën frymën e përafrimit të legjislacionit me Paketën e Tretë Rregullatore të Bashkimit Europian.

- Të angazhohet në uljen e barrierave administrative për licencimin dhe autorizimin e investimeve në energjinë e rinovueshme dhe lidhjen e prodhuesve të energjisë së rinovueshme me rrjetin energjetik.

- Të angazhohet në forcimin e kapaciteteve administrative dhe rritjen e pavarësisë operacionale të tij.

- Përpara çdo vendimi që do të sjellë ndryshimin e çmimit të energjisë, të analizojë dhe të marrë në konsideratë edhe përmirësimin/përkeqësimin e ndjeshëm të nivelit të arkëtimeve dhe humbjeve.

KRYETARI
Ilir Meta

Miruar në datën 22.5.2014

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 12 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006